

ANALIZA E VLERAVE TË COPËTIMIT TË RELIEVIT NË PJESËN VERILINDORE TË KOSOVËS

(ANALYSIS OF FISSURE VALUE OF THE LANDSCAPE IN THE NORTH EASTERN PART OF KOSOVA)

Shpejtim BULLIQLI, Florim ISUFI, Gani GASHI
Departamenti i Gjeografisë, Universiteti i Prishtinës,
KOSOVË

E-mail: *shbulliqi2000@yahoo.com*

PËRMBLEDHJE

Mbështetur në paraqitjen e vlerave të copëtimit të relievit ku mbizotëruese janë ato të mëdha dhe mesatare, arrihet në përfundimin se janë rrjedhojë dhe njëherazi dëshmi e një evolucioni morfotektonik e morfoklimatik relativisht të vrullshëm. Vlerat e dendësisë së copëtimit të relievit në këtë pjesë kushtëzohen nga: shtrirja e shkëmbinjve të papërshkueshëm (rreshporë të butë), shkalla e thellësisë së copëtimit, pjerrtësia e shtratit të rrjedhjeve ujore, pjerrtësinë e shpateteve, etj. Natyrisht faktori kryesor, i cili ka ndikuar në dallimin në mes të vlerave të copëtimit në relievin e njësive morfostrukturore është amplituda shumë më e vogël e ngritjeve tektonike të njësive morfostrukturore të Gollakut në krahasim me ato të Kopaonikut.

Fjalët kyçe: copëtimi vertikal, copëtimi horizontal, thyrje tektonike, veprimtari erozive, dendësi e ndërthurjes.

SUMMARY

Based on introduction of the fissure values of the landscape, where those large and medium ones dominate, it comes to a conclusion that they are an outcome and evidence of a morph tectonic and morph climatic relatively vigorous changes.

The values of landscape fissure density in this part are conditioned by: expansion of impenetrable rocks (mild schistose), level of fissure deepness, slope of water flow beds, slope of banks, etc. The very low amplitude of tectonic increase of Gollak morph structural units compare to those of Kopaonik is the main factor that influenced differentiation between the fissure values in the landscape of morpho structural units.

HYRJE

Njëra prej njësive natyrore fiziko-gjeografike të hapësirës së Kosovës, pjesa VL e saj, zë një vend të rëndësishëm dhe me tipare karakteristike. Kufijtë natyror të kësaj hapësirë janë lugina e mesme e lumit Ibër, nga Mitrovica te grykëderdhja e lumit të Bisticës (dega e djathtë) në VP, kurrizi kryesisht kodrinor i Çyçavicës në JP, lugina e lumit të Graçanicës dhe ajo e epërme e lumit të Ballabanit në JL e lindje, kurse gjithë pjesa tjetër VL e veriore deri te maja e Pançitit (2017m) kalon gjatë vijës kufitare me Serbi-Mali i Zi. Ka një shtrirje tipike VP-JL me gjatësi rreth 77km dhe gjerësi 12-40 km, kurse lartësinë me të lartë e ka në skajin VP te maja e Pançitit, ndër më të lartat në Kosovë. Njësitë morfologjike kryesore të kësaj pjesë janë vargmallet e Kopaonikut në VP, pellgu grabenor i Llapit në

VL, pjesa VP e Fushës së Kosovës në JP dhe relievi kodrinoro-malor i Gollakut në JL. Një nga treguesit morfologjik më të dukshëm të këtyre ndryshimeve janë vlerat e dendësisë dhe ato të thellësisë së copëtimit të relievit të kësaj pjese, të cilat paraqiten mjaft të ndryshme në varësi të faktorëve dhe kushteve të zhvillimit. Rëndësia e këtyre parametrave është e madhe si në aspektin praktik ashtu edhe në atë teorik. Këto vlera mundësojnë të bëhet përcaktimi i dendësisë së ndërthurjes së luginave, terreneve karstike, si dhe zonave me veprimtari të madhe erozive etj. Përmes vlerave të copëtimit vertikal ka mundësi të identifikohen hapësirat më thyrje tektonike të vogëla apo më të mëdha si dhe veprimtarit erozive në thellësi.

METODA E PUNËS

Kategorizimi dhe krijimi i hartave të vlerave të copëtimit të relievit është kryer me GIS dhe Remote Sensing. Në radhë të parë është bërë digjitalizimi i izohypseve dhe transformimi në pikësell me vlera tri dimensionale pas se cilave pason gjeoreferencimi dhe krijimi i MDRSAR ku distanca hapsinore në mes pikave është 20m. Pas formimit të MDR-së në formatin GRID në nuancat e të përhimtës krijohën kushtë e transformimit më të lehtë dhe më saktësi të madhe në Virtual GIS. Kjo ka mundësuar interpolimin e pikave me vlerat tridimensionale dhe krijimin e hartave të punës.

ANALIZAT E VLERAVE TË COPËTIMIT TË RELIEVIT

Në kuadrin e karakteristikave të përgjithshme të relievit, të pjesës VL të Kosovës krahas relievit malor të Kopanikut një vend të rëndësishëm zënë edhe relievi kodrinor, i cili shtrihet gati tërësisht në territorin e Gollakut. Ndryshimet e lartësive midis relievit malor ndaj pellgut grabenor të Llapit dhe Fushës së Kosovës arrijnë 900-1400 m, kurse e atij kodrinor të Gollakut 200-500 m. Këto vlera të ndryshimit të lartësive relative në relievin e kësaj pjese lidhen drejtpërdrejtë me amplitudën e diferencimit tektonik të ri dhe atij të sotëm midis strukturave gjysëmhorstike të Kopaonikut e Gollakut dhe atyre grabenore të Llapit e Fushës së Kosovës. Pjesa më e madhe e relievit malor shtrihet në lartësinë 1000-1200 m, e

cila është pothuajse e përafërt me lartësinë mesatare të tij, kurse ajo e relievit kryesisht kodrinor të Gollakut arrin 700-900 m, duke pasqyruar kështu drejtpërdrejtë vlerat e diferencimit tektonik të strukturave ku është modeluar ky reliev.

Rrjedhjet e kësaj dukurie tektonike janë ndryshimet morfologjike midis shumëllojshmërisë së formave të relievit të ndihmuara edhe nga përbërja litologjike me shkallë fortësie të ndryshme midis magmatikëve e terrigenëve. Një nga treguesit morfologjik më të dukshëm të këtyre ndryshimeve janë vlerat e dendësisë dhe ato të thellësisë së copëtimit të relievit të kësaj pjese, të cilat paraqiten mjaft të ndryshme në varësi të faktorëve dhe kushteve të zhvillimit.

Shkëmbinjët flihor ndërtojnë pjesën më të madhe të njësinë morfologjike të Gollakut dhe pjesën VL të kurrizit malor të Kopaonikut, të cilët formojnë kryesisht relieve kodrinore shumë të copëtuara nga rrjeti e dendur i rrjedhjeve ujore. Shkalla e këtij copëtimit lidhet edhe me shkallën e lartë të copëtimit tektonik të këtyre shkëmbinjëve në drejtim kryesisht VP-JL, duke kushtëzuar një drejtim të tillë edhe të luginave lumore kryesore. Rëndësia morfologjike e tyre lidhet edhe me ripërtëritjen tektonike të këtyre shkëmbinjëve, me amplitudë 800-1400 m, duke krijuar forma të larmishme e me kontraste morfologjike të dukshme, veçanërisht në VL të Kopaonikut.

Natyrisht një shtrirje të gjerë në këtë pjesë kanë edhe shkëmbinjët magmatikë intruziv, ultrabazikë dhe ato efuziv diabazik, andezite, bazalte etj, duke u renditur menjëherë pas atyre terrigen të lartpërmendur me moshë nga Jurasi-ku në Miocen. Pjesa dërmuese e tyre ndërtojnë relievin më të lartë malore të pjesës VP të vargmalit të Kopaonikut, duke kushtëzuar njëherazi edhe vlerat e larta të dendësisë dhe thellësisë së copëtimit të tij. Shkalla e lartë e tektonizimit të tyre, lidhur me tektonikën e re bllokore dhe shkëputjet e dendura tektonike që i shoqërojnë kryesisht të karakterit normal, që kanë përcaktuar njëherazi edhe kontrastet morfologjike të theksuara në reliev. Në trajtën e brezave me gjerësi 1-4 km këta shkëmbinj shtrihen në skajin lindor e perëndimor të pellgut grabenor të Llapit dhe të njësisë morfologjike të Gollakut,

duke krijuar relieve me ndryshime të dukshme ndaj atyre të formuar në fliшет kufizuese. Vlen të theksohet se në përgjithësi rëndësia morfologjike e këtyre shkëmbinjve lidhet ngushtë jo vetëm me shkallën e fortësisë së tyre, por edhe me vlerat e amplitudës së ngritjeve tektonike të reja ku ato janë përfshirë.




Fig. 1. Harta e copëtimit horizontal të relievit

Vlen të theksohet se arealet e shtrirjes së vlerave të dendësisë së copëtimit të relievit në këtë pjesë kushtëzohen drejtpërdrejtë me ato të shtrirjes së shkëmbinjve të papërshkueshëm, veçanërisht të atyre rreshporë të butë. Në vlerat e këtij copëtimi ndikon, gjithashtu shkalla e thellësisë së copëtimit, me të cilin lidhet niveli bazë lokal e erozionit dhe pjerrësia e shtretërve të rrjedhjeve ujore, së bashku me pjerrësinë e shpateve. Natyrisht vlerat më të mëdha të dendësisë së copëtimit shtrihen në pjesën JL e JP të vargut malor të Kopaonikut ($4-7\text{ km/km}^2$), ku dallohet sidomos sektori i epërm i rrjedhjes së lumit Llap e Bistrica. Ndërsa në Gollak, me vlera të mëdha karakterizohet pjesa veriore, veçanërisht sektori i epërm i rrjedhjes së lumit të Batllavës dhe Graçanicës (Figura 1).

Këto dukuri te dendësisë së copëtimit në territoret e lartpërmendura të kësaj pjese lidhet në

radhë të parë me përbërjen terrigjene dhe magmatike tepër të copëtuara nga shkalla e lartë e tektonizimit të tyre, veçanërisht e këtyre të fundit tepër të ndjeshme ndaj veprimtarisë tektodina-mike. Kësisoj këta shkëmbinj duke pasur parasysh shkallën e lartë të tektonizimit kanë kushtëzuar edhe mundësinë e formimit të rrekëzave dhe rrekëve të cilat kanë mundësuar këto shkallë copëtimi. Kësisoj nëpër këto territore kemi te lokalizuara edhe një numër të vendbanimeve të cilat kanë kushtëzuar edhe dëmtimin e bimësive natyrore. Me këtë të fundit lidhet edhe prania e këtyre vlerave krahas faktorëve tjerë të përmendur më lart. Me shkatërrimin tektonik dhe faktorët që u përmendën më lart lidhen edhe vlerat më të mëdha të copëtimit të relievit pikërisht në territoret e ndërtuara nga shkëmbinjte magmatikë, të tillë si ne sektorin e epërm te lumit të Batllavës dhe te ai i Bistricës ($5-7\text{ km/km}^2$). Kurse vlerat mesatare të dendësisë së copëtimit të relievit përgjithësisht shtrihen gjatë ujëndarësve të Gollakut, pra midis luginës së lumit të Batllavës, Tërnavës, Grashticës, Siçevës etj, në të cilat ruhen fragmentet e sipërfaqes erozionale neogjenike.

Në këto territore takohen edhe vlerat e vogla të këtij copëtimi, gjë që lidhet edhe me përmasat e vogla të pellgjeve ujëmbledhëse dhe sasinë e ulët të lagështisë ($500-600\text{ mm rreshje/vit}$). Vlera të tilla janë karakteristike edhe për territoret midis Bajgores e Kaçanollit, me shkëmbinj magmatikë miocenikë (brekçe, tufet vullkanike) mjaft të qëndrueshëm ndaj veprimtarisë gërryese të rrjedhjeve ujore.

Relievi i kësaj pjese dallohet edhe për vlerat e mëdha të thellësisë së copëtimit, të cilat lidhen ngushtë me ato të dendësisë së copëtimit, pra edhe më përbërjen litologjike nga shkëmbinjte magmatikë të fortë dhe pak të përshkueshëm, të përfshirë nga lëvizjet tektonike ngritëse me amplitudë të madhe. Natyrisht dukuria morfogjenike e jashtme kryesore është veprimtaria e rrjedhjeve ujore dhe shpëlarjet e përqendruara deri në përmasat e përrënjve, të cilat kanë krijuar vlerat e mëdha të thellësisë së copëtimit të relievit, duke krijuar kontraste morfologjike mjaft të shprehura të tij.

Territoret me vlera të mëdha të thellësisë së copëtimit, të cilat janë mbizotëruese në këtë




Figura 2. Harta e copëtimit vertikal të relievit

pjesë, janë ato deri në 300-500 m/km² dhe shtrihen në pjesën dërmuese të vargmali të Kopaonikut, sidomos në pjesën VP të tij (Figura 2).

Këto vlera shtrihen gjatë grykës së rrjedhjes së epërme të Bisticës deri te maja e Pançicit, ajo e lumit të Sedrave, të Dobravës, ku veçohen ato të degëzimeve të lumit të Llapit midis Sylevicës dhe Murgullës. Për ndryshim nga vargu malor i Kopaonikut, relievi i Gollakut dallohet për vlera mesatare (150-300 m/km²) dhe të vogla (50-100 m/km²) të thellësisë së copëtimit të relievit. Të parat shtrihen në sektorët e epërm të rrjedhjeve ujore, e lidhen jo vetëm me lartësitë më të mëdha në pjesën qendrore të Gollakut, por edhe me shkëputjet tektonike të shfrytëzuara prej tyre. Natyrisht faktori kryesor, i cili ka ndikuar në këto vlera, është amplituda shumë më e vogël e ngritjeve tektonike të njësive morfo-strukturore të Gollakut në krahasim me ato të Kopaonikut.

Kjo dukuri tektonike shprehet mjaft mirë në faktin se në të njëjtit lloje shkëmbinjsh, pra magmatikë ose terrigjen, shtrihen terrene me vlera të ndryshme të thellësisë së copëtimit. Kështu në shkëmbinj të magmatikë të relievit malor në rrjedhjen e epërme të lumit të Bisticës janë të pranishme vlera shumë të mëdha të thellësisë së copëtimit, kurse në sektorin e epërm të lumit të

Batlavës, i cili ndërtohet nga të njëjtit shkëmbinj, përkundrazi takohen vlera mesatare deri në të vogla të këtij copëtimi. E njëjta dukuri ndodh edhe në relievet e ndërtaura prej shkëmbinjve terrigjen, të tillë si rrjedhja e lumit të Kaçanolit, me vlera të mëdha të thellësisë së copëtimit në sektorin e epërm të tij, kurse ai i Tërnavës dallohet për vlera mesatare dhe të vogla të këtij copëtimi.

Lidhur ngushtë me vlerat e dendësisë dhe ato të thellësisë së copëtimit të relievit në këtë pjesë qëndron edhe ekspozicioni i shpateve, i cili dallohet nga një shtrirje e përcaktuar dukshëm edhe prej drejtimit të zgatjes së njësive morfostrukturale kryesore. Drejtimet kryesore të ekspozicionit të shpateve janë ai JP e VL, të cilët lidhen drejtpërdrejtë me një shtrirje të tillë të strukturave dhe formave kryesore të relievit gjatë tyre, pra kurrizeve malore dhe luginave lumore (Fig. 3). Drejtimi gati meridional i pellgut grabenor të Llapit ka përcaktuar drejtimit të tillë edhe për shpatet tektonike kufizuese, kurse drejtimi JP i luginave gjatë pjesës VP të vargmalit të Kopaonikut shprehet në ekspozicionin JL e VP të shpateve në këto lujna.




Figura 3. Harta e ekspozicionit të shpateve

Mbështetur në paraqitjen e vlerave të copëtimit të relievit në këtë pjesë ku mbizotëruese janë ato të mëdha dhe mesatare, arrihet në përfundimin se ato janë rrjedhojë dhe njëherazi dëshmi e një evolucioni morfotektonik e morfoklimatik relativisht të vrullshëm edhe në ditët e sotme. Në këtë kuadër njohja e këtyre vlerave dhe shpërndarja e arealeve të tyre në këtë zonë, paraqet rëndësi të veçantë praktike për marrjen e masave paraprake në drejtim të parandalimit të dëmeve ekonomike, veçanërisht për ndërtimin e qendrave urbane, infrastrukturës hidroteknike, bujqësisë, industrisë etj.

BIBLIOGRAFIA

1. BULLIQI, Sh. (2006), *Veçoritë morfologjike të pjesës VL të Kosovës*, Prishtinë, Disertacioni i Doktoraturës (dorëshkrim).
2. BULLIQI, Sh. (2000), *Veçoritë fiziko-gjeografike të fushëgropës së Llapi*, Prishtinë, punim i Magjistraturës (dorëshkrim).
3. GRUDA, Gj. (1982), *Origjina dhe evolucioni gjeomorfologjik i luginave lumore të Alpeve shqiptare*, Bul. shken. Gjeol. nr. 2, Tiranë.
4. TALANI, R. (1997), *Praktikum i labratoreve dhe detyrave të hartografi-topografisë*, Shkodër, 1997.
5. Harta topografike: Prishtina, Mitrovica, Kushumlija, 1:100 000, V.G.I., Beograd, 1976.
6. Harta Gjeologjike e Kosovës 1:100.000, Komisioni i pavarur i minierave dhe mineraleve, Prishtinë, 2006.

